



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr 862 prot.

Tiranë, më 16.06.2023

V E N D I M

Nr.3, datë 31.05.2023

P Ë R

“MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR DISA ZONA KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, DRIN-BUNË 4, 5 DHE 6 (TERRITORI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE SHKODËR, ANA E MALIT, BËRDICË, DAJÇ, GURI I ZI, RRETHINAT DHE VELIPOJË TË BASHKISË SHKODËR DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE BUSHAT TË BASHKISË VAU I DEJËS)”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, të Kreut 3, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projektplanit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës), sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për publikimin Projektplanit si dhe koordinimin me autoritetet përkatëse të Malit të Zi, të masave të parashikuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.
3. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, që pasi të trajtojë dhe marrë parasysh të gjitha komentet në lidhje me Projektplanin, të disponuara gjatë periudhës 6-mujore të publikimit, të paraqesë për miratim planin përfundimtar në Këshillin Kombëtar të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLENKU

